



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

MBI
ADMINISTRIMIN E FONDIT TË GARANCISË SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT DHE
RASTET E NDËRHYRJES

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 86, datë 03.07.2017

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton rregulla mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rastet e ndërhyrjes.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë si dhe nga degët e shoqërive të huaja të sigurimit të cilat këtu e më poshtë do të quhen me termin e përbashkët “Shoqëria e sigurimit”.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 81, pika 7, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 4
Administrimi i Fondit të Garancisë

1. Shoqëritë e sigurimit investojnë Fondin e Garancisë vetëm në:
 - a. Bono thesari njëvjeçare (12-mujore të Qeverisë Shqiptare);
 - b. Depozita bankare me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Bonot e thesarit dhe/ose depozitat bankare të Fondit të Garancisë të investuara sipas pikës 1 të këtij neni, këtu e më poshtë do të quhen me termin e përbashkët “Investime”.
3. Totali i investimeve të Fondit të Garancisë në monedha të huaja nuk duhet të jetë më shumë se 30% e Fondit të Garancisë.
4. Investimet e Fondit të Garancisë në një bankë të vetme, nuk lejohet të tejkalojnë 25% të Fondit të Garancisë.
5. Shoqëria e sigurimit kujdeset të investojë Fondin e Garancisë duke konsideruar profilin e rrezikut të çdo investimi.
6. Bonot e thesarit sipas pikës 1 të këtij neni, emërtohen “Bono thesari për Fondin e Garancisë” dhe përmbajnë kushtin “Nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Autoritetit”.
7. Depozitat bankare sipas pikës 1 të këtij neni, janë depozita qëllimore dhe emërtohen “Depozitë për Fondin e Garancisë” dhe kanë si pjesë përbërëse të kontratës së depozitës kushtin “Kjo depozitë nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Autoritetit”.
8. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet dokumentin që vërteton blerjen e bonove të thesarit ose kontratën e depozitës bankare, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së investimit.

Neni 5

Ndryshimi i investimeve për Fondin e Garancisë

1. Një investim i Fondit të Garancisë mund të ndryshojë në rastet në vijim:
 - a. Nëse shoqëria kërkon të ndryshojë bankën ku ka investimin e Fondit të Garancisë;
 - b. Nëse shoqëria kërkon të ndryshojë llojin e investimit të Fondit të Garancisë;
 - c. Nëse shoqëria e sigurimit zotëron investime për Fondin e Garancisë në vlerë më të madhe se niveli i Fondit të Garancisë.
2. Për ndryshimin e investimeve për Fondin e Garancisë sipas pikës 1 të këtij neni shoqëria kërkon miratimin me shkrim nga Autoriteti të paktën 10 ditë kalendarike përpara kryerjes së ndryshimeve.
3. Në rastet e përcaktuara në pikën 1/b të këtij neni, së bashku me kërkesën për ndryshimin e investimit, shoqëria depoziton në Autoritet edhe fotokopje të kontratave në fuqi për të gjitha investimet për Fondin e Garancisë.

4. Autoriteti jep miratim për prekjen e investimit vetëm në rast se vlera e kontratës së investimit që kërkohet të ndryshohet është mbi vlerën e Fondit të Garancisë të kërkuar.
5. Autoriteti, brenda 5 ditëve pune nga marrja e kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, njofton me shkrim shoqërinë dhe bankën përkatëse në rastet kur miraton kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e investimit.
6. Pas kryerjes së transfertës, në rastin sipas përcaktimeve në pikën 1, germa a dhe b të këtij neni, shoqëria depoziton në Autoritet:
 - a. Një kopje të dokumentit të transfertës bankare me përshkrimin “Transferim shume për depozitë për fondin e garancisë”, në ditën e transferimit të shumës;
 - b. Një kopje të vërtetimit për investimin në bono thesari 1-vjeçare, me kërkesat sipas pikës 6, të nenit 4, të kësaj rregulloreje;
 - c. Kontratën e re të depozitës, në ditën e lidhjes së saj, me kërkesat sipas pikës 7, të nenit 4, të kësaj rregulloreje;
 - d. Dokumentat sipas gërmave a, b dhe c të kësaj pike depozitohen në Autoritet në formë shkresore dhe elektronike brenda 2 ditëve nga dita e kryerjes së transaksionit dhe/ose e lidhjes së kontratës.

Neni 6

Ndërhyrja në Fondin e Garancisë

Në Fondin e Garancisë ndërhyhet vetëm me miratim të Autoritetit dhe vetëm kur shoqëria e sigurimit ndodhet në procesin e likuidimit apo falimentimit.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Shoqëritë e sigurimit të cilat në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje kanë investime të Fondit të garancisë të pamaturuara, do të vazhdojnë t'i mbajnë ato deri në datën e maturimit të tyre.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.